



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.19/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Subjekti Politik Lista Serbe me seli në Mitrovicën e Veriut, dhe ankesën e parashtruar nga Gordana Laban Zuvic, anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Vendimi Nr.01/30-2025, për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi Nr.01/31-2025, për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, të datës 08.01.2025, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHEN të bazuara ankesat Anr.19/2025 e datës 10.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lista Serbe me seli në Mitrovicën e Veriut, dhe Anr.22/2025 e datës 10.01.2025, e parashtruar nga Gordana Laban Zuvic, anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, ANULOHEN Vendimi Nr.01/30-2025 i datës 08.01.2025 për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi Nr.01/31-2025, i datës 08.01.2025 për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe çështja kthehet në rivendosje në KQZ.

A r s y e t i m

PZAP më datë 10.01.2025, ka pranuar ankesën nga Subjekti Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, me të cilën thekson se më datë 08.01.2025 janë marrë dy vendime, Vendimi Nr. 01/30-2025, datë 08.01.2025 për Miratimin e Përbërjes së Grupeve për Numërim në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi Nr. 01/31-2025 i datës 08.01.2025 për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Votimit në vendvotimet e rregullta dhe me kusht, të cilët Subjekti Politik Lista Serbe konsideron se KQZ-ja, ka shkelur ligjin me Vendimin Nr.01/30-2025 dhe Vendimin Nr.01/31-2025 të datës 08.01.2025, përkatësisht nenet 63 dhe 64 paragrafin 2.10, neni 75, neni 76, neni 77, neni 78 dhe nenin 101 të Ligji nr. 08/ L-228 për zgjedhjet e

përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 20 i Rregullores së Zgjedhjeve Nr. 16/2024 Qendrat komunale të numërimit, si dhe nenit 5 paragrafi 1 i Rregullores së Zgjedhjeve nr. 10/2024 Komisionet Zgjedhore. Tutje në ankesë pala ankuese ka theksuar se Subjekti Politik Lista Serbe beson se përbërja e këtyre komisioneve është jo legjitime dhe në kundërshtim me ligjin dhe se disa subjekte politike janë të favorizuara, ndërsa subjekti politik Lista Serbe është e diskriminuar për shkak se atyre u është caktuar një numër shumë më i vogël kryesuesish, anëtarësh dhe anëtareve rezervë se sa që KQZ-ja do të kishte qenë në përputhje me ligjin ndaj subjektit politik që ka fituar më shumë vota nga komuniteti serb në zgjedhjet e fundit.

Në ankesë Subjekti Politik Lista Serbe ka theksuar se në Komunën e Istogut Subjekti Politik Lista Serbe ka fituar 259 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, edhe pse janë parti parlamentare, nuk kanë një kryetar të komisionit të votimit, as një anëtar të komisionit të votimit, as një kryetar apo anëtar në qendrën komunale për numërimin e votave, as një anëtar në vendin e votimit me kusht. Në Komunën e Klinës Subjekti Politik Lista Serbe ka fituar 213 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, nuk kanë asnjë anëtar në Qendrën Komunale për numërim, ndërsa Subjekti Politik Liria Drejtësia dhe Mbijetesa mori 10 (dhjetë) anëtarë të komisionit të vendvotimit. Në Komunën e Fushë Kosovës Subjekti Politik Lista Serbe ka fituar 237 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, tani nuk ka asnjë kryetar apo anëtar të komisionit zgjedhor, as një kryetar apo anëtar në qendrën komunale për numërim, si dhe asnjë anëtar në vendin e votimit me kusht, ndërsa Subjekti Politik Lira, Drejtësia dhe Mbijetesa, i cili është i favorizuar nga Vetëvendosje dhe partitë tjera shqiptare, me vendime të kontestuara është shpërblyer me 14 anëtarë në Komisionet Zgjedhore dhe 1 anëtar rezervë, edhe pse ka fituar vetëm 17 vota në zgjedhjet e vitit 2021. Në komunën e Kamenicës Subjekti Politik Lista Serbe ka fituar 718 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, nuk kanë asnjë kryetar në Komisionet zgjedhore, nuk kanë asnjë anëtar në qendrën komunale të numërimit, dhe nuk ka asnjë anëtar apo kryetar të vetëm për vendet ku votohet me kusht, ndërsa Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa, i janë ndarë 12 anëtarë në Komisionet Zgjedhore. Në Komunën e Leposaviqit Subjekti Politik Lista Serbe ka fituar 8129 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, kanë të njëjtin numër të përfaqësuesve në komisionet e votimit si Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa i cili ka fituar 19 vota në vitin 2021. Po në këtë komunë, nga 168 përfaqësues në Komisionet Zgjedhore, 104 janë caktuar për partitë shqiptare. Në Komunën e Lipjanit Subjekti Politik Lista Serbe ka fituar 268 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, nuk kanë asnjë kryetar, nuk kanë asnjë anëtar apo kryetar të vetëm për vendet ku votohet me kusht. Derisa, në Komunën e Novobërdës Subjekti Politik Lista Serbe fitoi 51,13% të votave në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, por në Qendrën Komunale të numërimit nuk ka rezervë dhe gjithashtu nuk kanë asnjë anëtar në vendet ku votohet me kusht. Nga numri i përgjithshëm i parashtrësve drejtuar Komisioneve Zgjedhore, që është 120, përfaqësuesit politikë shqiptarë morën 94 mandate, subjekti politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa, e cila fitoi një numër të vogël votash në vitin 2021, 12 mandate, ndërsa subjekti politik Lista Serbe fitoi 51,13 % në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, prej votave mori vetëm 24 vende në Komisionet Zgjedhore.

Në Komunën e Obiliqit subjekti politik Lista Serbe ka fituar 938 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, tani nuk kanë asnjë anëtar në qendrën komunale të numërimit, as nuk kanë një anëtar dhe kryetar në vendet ku votohet me kusht. Ndërsa në të njëjtën kohë subjekti politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa, ka numër të njëjtë të përfaqësuesve si Subjektit Politik

Lista Serbe në Komisionet Zgjedhore, edhe pse ajo ka fituar 24 vota në zgjedhjet e vitit 2021. Në Komunën e Rahovecit subjekti politik Lista Serbe fitoi 303 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021 dhe tani nuk kanë asnjë anëtar në qendrën komunale të numërimit, nuk kanë as një anëtar dhe kryetar në vendet ku votohet me kusht. Ndërsa Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa, ka numër më të madh të përfaqësuesve si Subjekt Politik Lista Serbe në Komisionet Zgjedhore, edhe pse fitoi 3 vota në zgjedhjet e vitit 2021. Në komunën e Pejës subjekti politik Lista Serbe ka fituar 438 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021 dhe tani nuk kanë asnjë anëtar në qendrën komunale të numërimit dhe as një anëtar dhe kryetar në vendet ku votimi me kusht. Ndërsa në të njëjtën kohë Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa, ka numër më të madh të përfaqësuesve se Subjekti Politik Lista Serbe në Komisionet Zgjedhore, edhe pse fitoi 14 vota në zgjedhjet e vitit 2021. Në Komunën e Prishtinës subjekti politik Lista Serbe ka fituar 276 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021 dhe tani nuk kanë asnjë anëtar në Qendrën Komunale të Numërimit dhe as një anëtar dhe kryetar në vendet ku votohet me kusht. Ndërsa në të njëjtën kohë Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa, ka numër të njëjtë të përfaqësuesve si subjekti politik Lista Serbe në Komisionet Zgjedhore, edhe pse fitoi tre herë më pak vota në zgjedhjet e vitit 2021. Në Komunën e Prizrenit, Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa, ka dy anëtarë në vendvotime, ndërsa subjekti më i madh politik serb Lista Serbe nuk ka asnjë. Në Komunën e Shtërpçës, Subjekti Politik Lista Serbe fitoi 4031 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021 dhe tani nuk kanë përfaqësuesin e tyre në vendet ku votohet me kusht. Ndërsa në të njëjtën kohë Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa, ka numër të njëjtë të përfaqësuesve si Subjekti Politik Lista Serbe në Komisionet Zgjedhore, edhe pse fitoi 12 herë më pak vota në zgjedhjet e vitit 2021. Gjithashtu, duhet theksuar se në Komunën e Shtërpçës janë 17 komisione votimi, se vetëm në 4 komisione votimi kryesuesit janë nga subjektet politike serbe, ndërsa në 13 vendvotime kryesuesit janë nga subjektet politike shqiptare, edhe pse subjekti politik Lista Serbe fitoi 4031 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021 ose 64% të votave. Në Komunën e Vushtrisë subjekti politik Lista Serbe ka fituar 985 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021 dhe tani nuk kanë asnjë kryetar në vendvotim, as një kryetar apo anëtar në Qendrën Komunale të Numërimit, si dhe asnjë kryetar apo anëtar në vendet ku votohet me kusht. Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa, ka të njëjtin numër përfaqësuesve në Komisionet Zgjedhore si dhe Subjekti Politik Lista Serbe, edhe pse Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa, fitoi 17 vota në zgjedhjet e vitit 2021. Në Komunën e Zubin Potokut, Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa ka më shumë përfaqësues në Komisionet Zgjedhore se sa Subjekti Politik Lista Serbe. Subjekti Politik Lista Serbe ka 12 përfaqësues, ndërsa Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa ka 17 përfaqësues, në zgjedhjet e vitit 2021 Subjekti Politik Lista Serbe ka fituar 4288 vota, ndërsa subjekti politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa fitoi 1 votë. Gjithashtu, nga gjithsej 14 vendvotime, Lista Serbe ka 2 kryesues, ndërsa Subjekti Politik Vetëvendosje ka 4 kryesues, ndërsa partitë e tjera shqiptare 6 kryetarë të tjerë. Kështu që në këtë komunë, ku shumica e popullsisë janë 95% serbë, kemi parti shqiptare me gjithsej 10 kryesues në vendvotime. Në Komunën e Graçanicës, subjekti politik Lista Serbe ka fituar 4347 vota në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021. Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa ka 26 përfaqësues dhe Lista Serbe 28 përfaqësues në vendvotime. Edhe pse Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa fitoi 11 herë më pak vota se subjekti politik Lista Serbe. Gjithashtu, në njërin nga komunat më të mëdha me shumicë serbe, numri i kryesuesve të qendrave të votimit iu caktua përfaqësuesve politikë shqiptarë në numër më të madh, edhe pse krahasuar me Lëvizjen Vetëvendosja, Lista Serbe ka marrë 11 herë

më shumë vota, ata kanë 34 përfaqësues në vendvotime dhe Lista Serbe ka 28 përfaqësues në vendvotime. Në Komunën e Ranillugut subjekti politik Lista Serbe ka fituar 1827 vota ose 92,78% në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, tani kemi të njëjtin numër të përfaqësuesve në Komisionet Zgjedhore, si Subjekti Politik Liria, Drejtësia dhe Mbijetesë, i cili arriti gati 30 herë më pak vota. Në Komunën e Parteshit, Subjekti Politik Lista Serbe fitoi 1706 vota ose 94,15% të votave në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, të gjitha partitë e tjera në total pak më shumë se 5% ose më pak. Në Komunën e Kllokotit, subjekti politik Lista Serbe ka fituar pothuajse 50% të votave në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, me shumicë serbe, ka 8 përfaqësues në Komisionet Zgjedhore, d.m.th. 1/5 e një e pesta, megjithëse jemi parti më e madhe, kemi vetëm një kryesues komisioni derisa në të njëjtën kohë. Përfaqësuesit politikë shqiptarë kanë secili nga 2 kryetarë në Komisionet Zgjedhore. Në komunën e Mitrovicës së Veriut, Lista Serbe si parti parlamentare ka 18 përfaqësues në Komisionet Zgjedhore, përkatësisht 3 kryesues në Komisionet Zgjedhore dhe 15 anëtarë në Komisionet Zgjedhore. Ndërsa subjekti politik Vetëvendosje ka 6 kryetarë në Komisionet Zgjedhore dhe 18 anëtarë në Komisionet Zgjedhore, e njëjta situatë me PDK-në dhe LDK-në. Pra, në qytetin e tyre, ku kanë fituar pothuajse 70% të votave në vitin 2021, kanë 3 kryetar nga gjithsej 24 kryetarë.

Sipas palës ankuese me vendime të tilla Subjekti Politik Lista Serbe diskriminohet në raport me subjekteve të tjera politike që përfaqësojnë komunitetin serb, konkretisht Liria, Drejtësia dhe Mbijetesë po ashtu diskriminohet edhe ndaj subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin shqiptar. Sipas subjektit politik Lista Serbe ky vendim bie ndesh drejtpërdrejt me paragrafin 2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 për Komisionet Zgjedhore. Duke i propozuar PZAP të marrë një vendim me të cilin do të shfuqizohen vendimet e paligjshme dhe antikushetuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përputhje me paragrafin 1 të nenit 53, paragrafin 4 të nenit 131 dhe paragrafin 5 të nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të vërtetojë se vendimi nr. 01/30-2025 dhe Vendimi nr. 01/31-2025 të datës 8 janar 2025 janë të paligjshëm sepse vendimi është bazuar në diskriminimin etnik të komunitetit serb dhe veçanërisht Subjektit Politik Lista Serbe.

Po ashtu PZAP më datë 10.01.2025, ka pranuar një ankesë nga Gordana Laban Zuvic, anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, me të cilën ka theksuar se më datë 07.01.2025 në orën 15:51 nga Zyrtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtarët e KQZ-së, përmes e-maili janë informuar lidhur me agjendën për mbajtjen e mbledhjes së KQZ-së, dhe se materiali punues i propozuar nga Komisioni për Operacione Zgjedhore nuk ju është dërguar përmes e-maili apo në forme fizike, nga zyrtarët përgjegjës, të cilat materiale parashtuesja e ankesës thekson se i ka shkarkuar nga KQZ/Bordet/Komiteti i Operacionit Zgjedhor, dhe i'a ka dërguar anëtarit të KQZ-së, Mufer Sinikut në e-mailin zyrtar, në mënyrë që ajo të shohë propozimin e votimit të propozuar nga Komisioni për Operacionin Zgjedhor në pikën 4.1.1 shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së anëtarëve të këshillit të qendrave të rregullta të votimit dhe qendrave të votimit me kusht, dhe 4.1 .2 Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së anëtarëve të ekipit të numërimit në qendrat komunale të numërimit.

Ankuesja në ankesë ka theksuar se KQZ-ja, me vendimin nr. 01/30-2025, për miratimin e përbërjes së ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), dhe me vendimin nr. 01/31-2025 të datës 08.01.2025 për miratimin e përbërjes së Komisioneve të

Votimit në vendvotime të rregullta dhe me kusht, ka shkelur ligjin, pra nenet 63, 64 paragrafi 2.10, neni 75, neni 76, neni 77 neni 78 dhe nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L -228 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 20 të Rregullores së Zgjedhjeve nr. 16/2024 për Qendrat komunale të numërimit, si dhe neni 5 paragrafi 1 i Rregullores së Zgjedhjeve nr. 10/2024 për Komisionet Zgjedhore. Sepse këto dy vendime sipas ankueses janë të ndryshme nga materialet e punës që iu janë dorëzuar për seancën e 02 të KQZ-së, prandaj anëtarët e KQZ-së

nuk kanë mundur as t'i votojnë këto vendime, por jemi mashtruar nga Komisioni Operativ Zgjedhor, d.m.th. KQZ votoi me 10 vota PRO propozimin që na është dorëzuar si material pune, në mënyrë që vendimet e miratuara më pas të ndryshojnë dukshëm në raport me vendimet për të cilat ka votuar KQZ.

Ankuesja i ka propozuar PZAP që të merr një vendim që do të shfuqizojë vendimet e paligjshëm dhe antikushtetues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përputhje me paragrafin 1 të nenit 53, paragrafin 4 të nenit 131 dhe paragrafin 5 të nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Për të gjitha që u cekën më sipër dhe në përputhje me nenet 118 dhe 119 të ligjit nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, pala ankuese propozon që PZAP ta miratojë ankesën si të bazuar, të vërtetojë se Vendimi Nr. 01/30-2025 i datës 08.01.2025 për miratimin e përbërjes së ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), dhe Vendimi nr. 01/31-2025 i datës 08.01.2025 për miratimin e përbërjes së Komisioneve të Votimit në vendvotimet e rregullta dhe ato me kusht, janë të paligjshëm sepse KQZ-ja nuk e ka votuar (d.m.th.) është ndryshuar pasi anëtarët e KQZ-së votuan, kështu që të njëjtat janë në kundërshtim me nenet 63 dhe 64 paragrafi 2.10, neni 75, neni 76, neni 77 dhe neni 78 dhe nenin 101 të Ligjit nr. 08/L-228, për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 20 të Rregullores së Zgjedhjeve nr. 16/2024 Qendrat komunale të numërimit, si dhe neni 5 paragrafi 1 i Rregullores së Zgjedhjeve nr. 10/2024 për Komisionet Zgjedhore.

Po ashtu ka kërkuar nga PZAP të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të marrë Vendim për miratimin e përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimin për miratimin e përbërjes së Komisioneve të Votimit në vendvotimet e rregullta dhe me kusht, në përputhje me propozimi i Komisionit për Operacione Zgjedhore të bashkangjitur në Materialin e punës për pikën 4.1.1 Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së anëtarëve të këshillit të vendvotimeve të rregullta dhe vendvotimeve me kusht; dhe pika 4.1.2 Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së anëtarëve të ekipit të numërimit në qendrat komunale të numërimit.

PZAP, iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje KQZ-së, me datë 10.01.2025, lidhur me ankesat A.nr.19/2025, dhe A.nr.22/2025, ndërsa në përgjigjen e KQZ-së, theksohet se gjatë vendimmarrjes për përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN-së, përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, KQZ është bazuar në nenin 74,75,76,77,78 dhe 101 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 20 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit si dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 12/2024 Votimi Numërimi dhe Menaxhimi i VV.

KQZ, gjatë ndarjes së vendeve përtej neneve të lartcekura është angazhuar që gjatë shqyrtimit dhe vendimmarrjes të përdorë një qasje gjithë përfshirëse sidomos për komunitetin jo shumicë duke i ndarë vende përtej prezencës së komuniteteve të caktuara në vendvotimet e ndryshme apo numrin e votave. Gjatë këtij procesi janë marrë për bazë aktet ligjore të cilat përkufizojnë qartë detyrat dhe funksionet e anëtarëve të KVV të shprehura në numër dhe funksione që nuk kalojnë numrin prej 5 anëtarëve në një KVV, mirëpo përtej këtij fakti KQZ në rastet e caktuara ka shtuar numrin e anëtarëve deri në 6 (gjashtë) anëtar më qëllim të përfshirjes edhe më të madhe të komuniteteve jo shumice në komunat përkatëse. Bazuar edhe në Kushtetutën e Republikës së

Kosovës mbi përbërjen e Kuvendit mbi bazën e së cilës 20 vende janë garantuar për komunitetin jo shumicë si dhe në të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2024, janë bërë edhe vlerësimet adekuate në bazën e të cilave ka dal edhe përbërja e secilës KVV bazuar në numrin komuniteteve në ato komuna, për aq sa kjo ka qene e mundur të realizohet për faktin e kufizimit të numrit të anëtarëve në KVV që është deri në pesë (5) anëtar dhe rritja e këtij numri e pamundëson funksionimin e KVV gjatë ditës së zgjedhjeve. Andaj, pretendimet e palëve ankuese mbi "zvogëlimin numrit e të KVV" nuk qëndrojnë për faktin se ndryshimet ligjore dhe të akteve nënligjore tashme kanë përcaktuar qartë përbërjen dhe funksionet e secilit anëtar të KVV. Përqindja e votave të fituara qoftë në nivel qendror apo në nivel lokal, nuk është kriter i cili përcakton përbërjen e KVV në komunat përkatëse. I vetmi kriter ligjor që ka të bëjë është nenit 77 paragrafi 3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili thotë se Kryesuesit e këshillave të vendotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë, ku edhe në këtë rast KQZ e ka anashkaluar këtë nen në disa raste, me qëllim të përfaqësimit sa më të madh të komuniteteve jo shumicë. Gjithashtu, KQZ është kujdesur që të siguroj përfaqësim të drejtë në KVV edhe për subjektet e reja që garojnë në zgjedhje edhe për të gjitha komunitetet shumicë dhe ato pakicë.

KQZ-ja ka marrë për bazë edhe paragrafin 4 të nenit 77, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili i jep kompetencë KQZ-së që pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKV-ve të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni. Andaj, në bazë të neneve të lartcekura, konsiderojmë se ankesat e ankuesve, janë të pa bazuara dhe si të tilla duhet të refuzohen.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar Ankesat A.nr.19/2025 i datës 10.01.2025 dhe A.nr.22/2025 i datës 10.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.19/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesve.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se:

Ankesat janë të bazuara.

Paneli duke vlerësuar lejueshmërinë e ankesave ka ardhur në përfundim se të njëjtat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në bazë të nenit 77 paragrafi 5 i ligjit Nr.08/L-228, ku parashihet që *"Kundër vendimit të KQZ-së për mos emërimin kryesuesit dhe anëtarëve të vendvotimit, subjektet politike dhe palët tjera me interes juridik mund të paraqesin ankesë në PZAP, brenda 48 orëve nga shpallja e vendimit nga KQZ. Ankesa shqyrtohet dhe vendoset nga PZAP brenda 72 orëve nga parashtrimi i saj"*, dhe nenin 4 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave.

Qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruesve të ankesave se, me rastin e marrjes së vendimeve nga KQZ, Vendimi Nr.01/30-2025, për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi Nr.01/31-2025, për

Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe mw Kusht, nuk janë respektuar dispozitat ligjore nga neni 77 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Rregullorja Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit si dhe Rregullorja Zgjedhore Nr.11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve.

Me dispozitën e nenit 77 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, parashihet që: *"Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuar që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë"*. Ndërsa paragrafi 4, i po të njëjtit nen parasheh që: *"Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKV-ve, të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni"*.

Me dispozitën e nenit 20 paragrafi 1 i Rregullores Zgjedhore 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit parashihet që: *"KQZ, me vendim, përcakton numrin e ekipeve të numërimit dhe numrin e anëtarëve brenda ekipeve të numërimit, sipas specifikave të komunave përkatëse"*, paragrafi 2 i Rregullores parasheh që: *"Kryesuesit e ekipeve të numërimit, zgjedhën në mënyrë të barabartë nga katër subjektet e para që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë dhe janë certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet aktuale"*. Ndërsa paragrafi 4 i kësaj rregullore parasheh që: *Procedura e nominimit dhe emërimit të ekipeve të numërimit bëhet në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregulloren Nr. 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve"*. Ndërsa në nenin 3 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve parashihet që: *"KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet, duke u bazuar në: 2.1. Numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune; 2.2. numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komunal"*.


Bazuar në shkresat e lëndës Paneli vlerëson se KQZ me vendimet e sipër theksuara nuk ka dhënë arsye se si është bërë caktimi i përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve, në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht si dhe Përbërja e Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit, ndërsa kjo nuk është qartësuar as përmes përgjigjes në ankesë të bërë nga KQZ-ja. KQZ ka për obligim që ndarjen e tillë të bëjë sipas kritereve dhe kushteve të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore dhe ndarja të bëhet duke trajtuar në mënyrë adekuate subjektet politike në

bazë të kriterëve të përcaktuara, në mënyrë që përfshirja të jetë e tillë që të reflektoj pjesëmarrje adekuate për të gjithë ata që marrin pjesë në garë elektorale, për këtë arsye Paneli ka vendosur që ti anulohet vendimet e atakuara duke kthyer çështjen në rivendosje në KQZ. Në rivendosje KQZ duhet që, bazuar në rregullat dhe kriteret e përcaktuara, duke respektuar parimin e barazisë dhe përfaqësimit për të gjithë që marrin pjesë në garë zgjedhore, të rivlerësojë çështjen e caktimit të përbërjes së Këshillave të Vendotimeve, në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht si dhe përbërjen e ekipeve të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i aprovuar ankesat si të bazuara.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.19/2025 më datën 13.01.2025

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.